

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Mihrie Krasniqi-Sheholli dhe bashkëpunëtoren profesionale Valbonë Fejza, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.D. nga fshati O., Komuna e P. ndërsa tani me vendbanim në Gj., për shkak të veprës penale në bashkëveprim Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.1773-12/2009 të dt.03.06.2009 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me dt.11.12.2018 në praninë e Prokurores së Shtetit Ajshe Ferati nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë në prezencë të palëve mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 12.12.2018 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

E.D. nga babai R. dhe nëna F., e vajzërisë A., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin O., Komuna e P. kurse tani me vendbanim në Gj., me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar-baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike-financiare, sipas evidencës penale të kësaj gjykate ka të dhëna se ka qenë i dënuar më parë dhe ndaj tij zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 29.04.2009 rreth orës 01:00 në Podujevë, në rrugën "Zahir Pajaziti" me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm pas marrëveshjes paraprake për të vjedhur në bashkëveprim posa janë afruar afër lokalit DPZ "Burimi" të dëmtuarit H. J. me përdorimin e forcës, me dara kaqavida dhe me anë të një paiseri kanë këputur drynin e derës, me forcë kanë hapur derën e lokalit, kanë hyrë brenda dhe nga aty kanë marrë 1 kasfortë (arkë) të metalit në të cilin gjendeshin 2 makina për shumëzimin e çelsave, njëra e tipit "Borkey" dhe tjetra e tipit "Kanash", 2000 copë çelsa të llojeve të ndryshme, 1 aparat digjital, 80 telefona të llojeve të ndryshme, 10 copë të tipit "LG", 10 copë "Sony Ericson", 20 copë "Samsung", 40 copë "Nokia", 3 copë MP3, MP4, 3 pako kutia me vegla të ndryshme-15 copë qipa të çelsave me kod dhe një sasi të pjesëve rezervë të makinave për shumëzimin e çelsave, këto sende i kanë vendosur dhe bartur me një karrocë dore, me ç'rast të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

- Me këtë ka kryer në bashkëveprim veprën penale në bashkëveprim Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 2, 3, 6, 11, 23, 34, 41, 42, 43, 44, 64 dhe nenit 253 të KPK-së si dhe në bazë të neneve 365, 366, 369, 370, 450, 453, 463 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Me dënim me kusht, ashtu që të akuzuarit E.D. i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti, në qoftë se i akuzuari gjatë kësaj kohe nuk do të kryej veprë të re penale, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale-paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 70 Euro (shtatëdhjetë/Euro), kurse në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 Euro (tridhjetë/Euro), të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

I dëmtuari H.J. nga fshati S., Komuna e P. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën, PP.II.nr.1773-12/2009 të dt.03.06.2009 kundër të akuzuarve E.D. nga fshati O., Komuna e P. ndërsa tani me vendbanim në Gj., D.J. nga P., rr:"..." pnr., M.A. nga fshati P., Komuna e P. dhe L.G. nga F., rr:"..." pnr., për shkak të veprës penale në bashkëveprim Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Gjykata me dt.09.01.2015 ka marr aktvendim për veqimin e procedurës penale P.nr.527/2009 duke vendosur lidhur me propozimin e prokurorit për veqimin e procedurës penale ndaj të akuzuarit E.D. në kuptim të nenit 36 par.2 të KPPRK-së për arsye të efikasitetit të procedurës penale pasi që nga informatat e Stacionit Policor në P. të dt.08.01.2015 thuhet se i akuzuari është larguar nga Kosova që 2 muaj e 2 javë në Gjermani.

Lidhur me këtë çështje penale i akuzuari u paraqit vullnetarisht në gjykatë dhe gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më dt.11.12.2018 gjatë së prezantuan Prokurorja e Shtetit Ajshe Ferati nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe i akuzuari.

I akuzuari në fillimit të shqyrtimit gjyqësor deklaroi: E pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 326 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Mbetem në tërësi pranë aktakuzës, kundër të pandehurit E.D. dhe kërkoj nga gjykata që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit ndërsa pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit.

I akuzuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e pranoj fajësinë, e ndjej veten të fajshëm, pendohem për këtë veprë penale, i kërkoj falje të dëmtuarit, kërkoj nga gjykata një dënim sa më të butë dhe i premtoj gjykatë se në të ardhmen nuk do të përsëritet.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale në bashkëveprim Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpall fajtor dhe i'u shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjkata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit të parapara me nenin 64 të KPK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, kërkim faljen ndaj të dëmtuarit, pendimin e tij si dhe faktin se nga kryerja e veprës penale e deri më tani kanë kaluar më tepër se 9 vite ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti se i njëjti është shpallur fajtor për vepër tjetër penale dhe është dënuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë-Dega në Podujevë me shenjen, P.nr.859/2011 të datës 30.04.2013, i cili ka arritur formën e prerë, prandaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit dhe ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par.1 dhe 2 nënparagrafi 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 452 par.1 të KPPRK-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizim të kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marr në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.158/2015 me dt.12.12.2018

Zyrtare Ligjore
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.